



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE

Tiranë më \_\_\_/\_\_\_/2023.

**Lënda :** Kthim përgjigje.

Në përgjigje të e.mailit tuaj datë 10.07.2023, me lëndë “**Kërkesë për informacion**” ku kërkonti përshkrim të detajuar të informacionit lidhur me subjektet e licensuara për të ushtruar veprimtarinë e guroreve (nxjerrjes së mineraleve që lidhen me këtë aktivitet, si nxjerrja e gurit gëlqeror, argjilës, gurëve dekorativ etj.) dhe për aktivitetin e prodhimit të lëndës së parë gëlqere përmes furrave, për periudhën 2010-korrik 2023 ju informojmë si më poshtë:

**Pyetja: 1**

Sa leje janë lëshuar për aktivitetin e guroreve dhe të furrave të gëlqeres?

-Specifikojini sipas viteve për secilën kategori: gurore/furrë gëlqere;

-Specifikojini sipas tipit të lejes;

-A janë realizuar dëgjesat me komunitetin në rastet kur parashikohen?

**Përgjigje: 1**

- Bashkëngjitur keni tabelën me listën e lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve ndërtimore sipas viteve që kërkonti me të dhënat përkatëse.

Nr	Vitet	Numri i Lejeve sipas mineralit ndërtimor (shfrytëzim me karriere)				
		Gure Gëlqeror & Brekçie Shpati	Argjile & Shiste Argjilore	Dekorative	Kuarc & Rere kuarcore	Bazalte
1	2010	285	33	78	9	3
2	2011	276	33	77	9	3
3	2012	282	38	80	7	3
4	2013	292	39	89	7	3
5	2014	250	20	81	6	3
6	2015	165	20	78	6	3
7	2016	167	19	74	7	4
8	2017	162	21	85	10	4
9	2018	167	21	92	9	4
10	2019	130	18	72	7	4
11	2020	135	17	71	7	4
12	2021	140	16	70	7	5
13	2022	135	12	70	6	4
14	Korrik 2023	149	12	74	6	4

Përsa i përket furrave të gëlqeres sqarojmë se AKBN nuk lëshon liçenca ose monitoron furrat e Gëlqeres.

- Lejet e sipërcituara në tabelën përmbledhëse janë të gjitha leje minerare shfrytëzimi të liçensuara.

- Dëgjuesat me publikun janë pjesë e procedurës për paisjen me Leje Mjedisore nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe nuk është objekt i punës tonë.

### **Pyetja: 2**

A është monitoruar zbatimi i këtyre lejeve?

-Nëse po, na informoni për rezultatet e monitorimeve;

### **Përgjigje: 2**

- Në zbatim të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar “*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, AKBN mbikqyr 2 (dy) herë në vit aktivitetin minerar në subjektet e licensuara me Leje Minerare Shfrytëzimi. Rezultatet e këtyre monitorimeve pasqyrohen në Raportet 6 mujore dhe vjetore të cilat i dërgohen Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe së fundmi publikohen edhe në faqen zyrtare të AKBN-së [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al).

### **Pyetja: 3**

A janë konstatuar mos përmbushje të detyrimeve nga subjektet e pajisura me leje ndaj AKBN-së?

-Nëse po, na informoni për veprimet e ndërmarra nga ana juaj;

### **Përgjigje: 3**

Në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve nga subjektet e pajisura me leje minerare A.K.B.N-ja në zbatim të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar “*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*”, *Kreu VIII “Kundravajtjet administrative, pezullimi dhe revokimi”* ushtron marrjen e masave sipas shkeljeve referuar neneve përkatëse të shprehura në ligj.

### **Pyetja: 4**

A janë konstatuar mos përmbushje të detyrimeve nga subjektet e pajisura me leje në raport me kushtet e miratuara në leje apo në kontratë?

-Nëse po, na informoni për veprimet e ndërmarra nga ana juaj;

### **Përgjigje: 4**

Si në përgjigjen e pyetjes Nr. 3, në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve nga subjektet e pajisura me leje minerare A.K.B.N-ja në zbatim të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar “*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*”, *Kreu VIII “Kundravajtjet administrative, pezullimi dhe revokimi”* ushtron marrjen e masave sipas shkeljeve referuar neneve përkatëse të shprehura në ligj.

### **Pyetja: 5**

A është monitoruar rikuperimi i mjedisit nga ana e këtyre subjekteve

-Nëse po, na informoni për rezultatet e monitorimeve;

### **Përgjigje: 5**

Subjektet minerare paguajnë një vlerë monetare vjetore për garancinë e rehabilitimi për sipërfaqen e liçensuar, e cila depozitohet në thesarin e shtetit, e ndarë kjo për vitet e vlefshmërisë së liçencës dhe sipërfaqes së llogaritur për shfrytëzim. Lejet e shfrytëzimit janë përgjithësisht në zhvillim. Lejet minerare që kanë prodhim të madh (Fabrikat e Çimentos), kanë kryer rehabilitim progresiv sipas një plani të miratuar. Rehabilitimi përfundimtar bëhet pas mbylljes së veprimtarisë minerare të shfrytëzimit i cili miratohet në Këshillin Teknik të AKBN-së.

#### **Pyetja: 6**

Për periudhën 2010-korrik 2023 sa masa administrative ka marrë AKBN ndaj subjekteve që janë konstatuar me shkelje ligjore teksa ushtronin aktivitetin e guroreve dhe të furrave të gëlqeres?

#### **Përgjigje: 6**

Gjatë monitorimit të aktivitetit minerar në subjektet e liçensuara me leje minerare shfrytëzimi, për periudhën e sipërcituar, Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, ka marrë masa administrative në ato raste kur është konstatuar veprimtari minerare në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Për vitin 2014 - 31 Masa Administrative

Për vitin 2015 - 3 Masa Administrative

Për vitin 2017 - 1 Masë Administrative

Deri në Korrik 2023 - 1 Masë Administrative

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së nuk monitoron furrat e Gëlqeres.

#### **Pyetja: 7**

A ka subjekte të cilëve i është pezulluar leja?

-Nëse po, na informoni për rezultatet, përfshirë të dhënat e detajuara të subjekteve;

#### **Përgjigje: 7**

Po, ka subjekte të cilëve i është pezulluar veprimtaria minerare në ato raste kur është konstatuar shkelje teknike gjatë monitorimit. Pezullimi është shoqëruar me lënien e detyrave përkatëse sipas afateve të përcaktuara. Në rastet kur këto detyra janë realizuar, subjektit i është njoftuar zyrtarisht vazhdimi i aktivitetit minerar. Në rastet e moszbatimit, ka vazhduar procedura e rregullt ligjore me njoftimet e revokimit deri në revokimin e plotë të lejes minerare të shfrytëzimit.

Për vitin 2015 - 31 Pezullime

Për vitin 2016 - 14 Pezullime

Për vitin 2017 - 19 Pezullime

Për vitin 2018 - 34 Pezullime

Për vitin 2019 - 17 Pezullime

Për vitin 2020 - 1 Pezullime

Për vitin 2021 - 1 Pezullime

Për vitin 2022 - 0 Pezullime

Deri në Korrik 2023 - 1 Pezullim

#### **Pyetja: 8**

A ka subjekte të cilëve i është revokuar leja?

-Nëse po, na informoni për rezultatet, përfshirë të dhënat e detajuara të subjekteve;

**Përgjigje: 8**

Për vitin 2013 - 68 Revokime

Për vitin 2014 - 108 Revokime

Për vitin 2015 - 68 Revokime

Për vitin 2016 - 18 Revokime

Për vitin 2017 - 4 Revokime

Për vitin 2018 - 44 Revokime

Për vitin 2019 - 30 Revokime

Për vitin 2020 - 0 Revokime

Për vitin 2021 - 4 Revokime

Për vitin 2022 - 8 Revokime

Deri në Korrik 2023 - 2 Revokime

*Bashkëlidhur këtij materiali do dërgojmë edhe tabelat përkatëse sipas viteve.*

**Pyetja: 9**

A ka subjekte të cilët janë gjetur në tejkalim të koordinatave të shfrytëzimit?

-Nëse po, na informoni për masat e marra, përfshirë të dhënat e detajuara të subjekteve;

**Përgjigje: 9**

Po, gjatë monitorimit në vitin 2014 janë konstatuar 4 (katër) subjekte që ushtronin aktivitet minerar jashtë koordinatave të shfrytëzimit. Në zbatim të ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 45, Pika 1, shkronja "a", për këto subjekte është marrë masë administrative.

Në vitin 2023, është marrë masë administrative për 1 (një) subjekt sipas Neni 45, Pika 1, shkronja "c".

**Pyetja: 10**

A ka subjekte të cilët janë gjetur në tejkalim të lejeve?

-Nëse po, na informoni për masat e marra, përfshirë të dhënat e detajuara të subjekteve;

**Përgjigje: 10**

Sipas përgjigjeve të pyetjes 9

**Pyetja: 11**

A ka subjekte të cilët janë gjetur duke operuar në sipërfaqen e Zonave të Mbrojtura apo nëse leja e tyre mundëson veprimtarinë në këto zona?

-Nëse po, na informoni për masat e marra, përfshirë të dhënat e detajuara të subjekteve;

**Përgjigje: 11**

AKBN është strukturë në varësi të M.I.E-s për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive minerare të shfrytëzimit në zbatim të ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Referuar informacionit dhe databazes që AKBN disponon numri i lejeve minerare jometalore, të cilat janë të pajisura me leje minerare shfrytëzimi dhe ushtrojnë aktivitet në zona të mbrojtura janë:

Nr	Nr. Leje	Data Akt-Miratimit	Emri i subjektit	Bashkia	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	Afati lejes
1	721/1	01.09.2003	SHPETIMI shpk	Pogradec	Saselisht	Gur Gëlqeror	10 vite
2	831	18.12.2004	BENAKS - 94 shpk	Pogradec	"Mademi", Peshkepi	Kuarc	20 vite
3	939/1	18.04.2006	BENAKS - 94 shpk	Pogradec	Perroi i Gllaves, Çerrave	Gur Gëlqeror	10 vite
4	1049/1	31.07.2007	ALLBENIA - FERRO shpk	Kukës	Kodra e Nocit, Kalla, Shishtavec	Kuarc	20 vite
5	1892	01.07.2020	ALARUP shpk	Pogradec	Ish Miniera qymyrit Alarup,	Qymyr Guri	25 vite

Referuar Ligjit Minerar, subjekti pajiset me leje minerare shfrytëzimi, vetëm pasi të ketë marrë Lejen Mjedisore përkatëse, në të cilën janë vendosur kriteret sipas legjislacionit Mjedisor.

Nese subjektit i revokohet leja mjedisore atëherë automatikisht bie dhe leja e shfrytëzimit.

AKBN nuk mund të ndërmarrë një plan për zhvendosjen e tyre.

Në lidhje me realizimin e rehabilitimit mjedisor për sipërfaqen e prekur nga shfrytëzimi ju bëjmë me dije se subjektet për sipërfaqen e prekur nga aktiviteti minerar, kanë depozituar dhe depozitojnë çdo vit në thesarin e shtetit Garancinë e Rehabilitimit të Mjedisit, sipas vlerës së përcaktuar në Akt-Miratimin e Ministrit.

#### **Pyetja: 12**

Lidhur me subjektin "DELIA GROUP" shpk, me Nipt-in J81517002U, që shfrytëzon vendburimin në Borizanë, Krujë, a është i pajisur me leje?

#### **Përgjigje: 12**

Shoqëria "DELIA GROUP" shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr. 794/1, datë 20.08.2004 dhënë për shfrytëzimin e mineralit të Gurit Gëlqeror në objektin "Borizanë", Bashkia Krujë, Qarku Durrës. Formatin e lejes minerare mund ta shkarkoni nga faqja zyrtare e Q.K.B-së.

#### **Pyetja: 13**

A janë konstatuar shkelje nga ana e këtij subjekti?

-Nëse po, na informoni në detaje.

#### **Përgjigje: 13**

Nga mbikëqyrja e realizuar në terren datë 12.04.2023, nga grupi i specialistëve të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së në subjektin “Delia Group” sh.p.k u konstatua se:

Në objekt është punuar në hapjen e rrugës për në karrier në një gjatësi rreth 1000 ml.

Punohej në për krijimin e sheshit për vendqëndrimin e makinerive dhe mjeteve të transportit. Gjithashtu punohej në ngarikimin dhe transportin e mineralit të gurit gëlqeror të prodhuar nga këto punime. Subjekti ka paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2022-2023.

**Subjektit ju la detyrë:**

**Aktiviteti minerar të kryhet pa përdorimin e lëndëve plasëse sipas akt-miratimit të planit vjetor të punës të miratuar në A.K.B.N.**

Nga kontrolli i ushtruar në terren me datë 07.07.2023 nga grupi i specialistëve të Drejtorisë Minerare të A.K.B.N-së u konstatuan **shkelje të dispozitave të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, për të cilin është marrë masë administrative sipas Neni 45, pika 1, shkronja “c”, dhe Neni 46, pika 1, shkronja “b”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORIA MINERARE